



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

03.01.2014

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Reagim ndaj shkrimit me titull: Dorëheqjet dhe Bordi i pakompletuar i AKP-së

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit reagon ndaj shkrimit të publikuar me datë 30.12.2013 në gazetën "Kosova Sot" me titull: "Dorëheqjet dhe Bordi i pakompletuar i AKP-së", ku autori i artikullit keqinformon lexuesit duke ofruar informacione tërësisht të pasakta për punën dhe aktivitetet e AKP-së gjatë vitit 2013.

Është i pavërtetë konstatimi në artikull, ku thuhet se: "Agjencia ka disa muaj që nuk ka bërë asnjë punë", apo konstatimi tjetër: "Mungesa e Bordit për një kohë të gjatë e ka hedhur në kolaps AKP-në".

E vërteta është se AKP gjatë vitit 2013 ka vazhduar me përmbushjen e mandatit të vet ligjor, duke kryer detyrat dhe përgjegjësitë e saja konform Ligjit. Agjencia gjatë vitit 2013 ka ekzekutuar 5 valë të shitjeve të aseteve dhe 3 valë të privatizimi. Nga të gjithë tenderët e zhvilluar në 2013, janë pranuar në total 773 oferta, prej të cilave 555 oferta janë pranuar për blerje të aseteve të NSh-ve, ndërsa në valët e privatizimit Agjencia ka pranuar 218 oferta gjatë vitit 2013.

Në këtë shkrim gjithashtu keqinformohen lexuesit për sa i përket numrit të kontratave të nënshkruara nga Agjencia, ku thuhet se: "Ky institucion nuk ka arritur të nënshkruar ndonjë kontratë". Ky konstatim është i pavërtetë dhe e vërteta është se numri i kontratave të nënshkruara në 2013 në total është 137 me vlerë totale 35 milionë e 235 mijë euro, prej të cilave vetëm në pjesën e dytë të vitit (qershordhjetor) janë nënshkruar 83 kontrata, nga shitja e aseteve 63 kontrata dhe nga privatizimet me spin-off 20 sosh të nënshkruara. Ne e ftojme gazetën dhe autorin e shkrimit që t'i vërtetoj në AKP këto të dhëna. Për më shumë, AKP ka pasqyruar aktivitetet e saj për vitin 2013 edhe në komunikatën e Bordit të Drejtorëve që pesë ditë më parë, me datë 24.12.2013 u është shpërndarë të gjitha mediave, dhe që gjendet e publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.

Agjencia edhe një herë kërkon nga gazetarët e kësaj gazete dhe nga stafi redaktues që të kërkojnë të dhëna në Agjenci, në mënyrë që të mirë informohet opinioni publik, detyrë kjo që duhet përmbushur me përgjegjësi si nga Agjencia, ashtu edhe nga mediumet.

Singerisht

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FUND

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org